




REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
Këshilli Administrativ**

V E N D I M

Nr. 34, datë 12.12.2019

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “MBI PROCEDURAT E PËRSHKRIMIT,
GJENERIMIT, EKZEKUTIMIT, KONTROLLIT DHE RIMBURSIMIT TË
RECETËS ELEKTRONIKE e-Rx”**


Në mbeshtetje të Nenit 30 dhe 31, të Ligjit Nr. 10383, datë 24.02.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të Nenit 5, gërrma “dh” të Statutit të Fondit, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Administrativ,

V E N D O S I:

1. Të miratojë rregulloren “Mbi procedurat e përshkrimit, gjenerimit, ekzekutimit, kontrollit dhe rimbursimit të recetës elektronike e-Rx”.
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, si dhe Drejtoretë Rajonale të Fondit, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi Nr. 44 datë 14.04.2017, për miratimin e rregullores “Mbi procedurat e përshkrimit, gjenerimit, ekzekutimit, kontrollit dhe rimbursimit të recetës elektronike e-Rx”, shfuqizohet.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

OGERTA MANASTIRLIU

KRYETAR I KËSHILLIT ADMINISTRATIV



FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

R R E G U L L O R E

Nr. 1, Datë 12.12.2019

**“MBI PROCEDURAT E PËRSHKRIMIT, GJENERIMIT, EKZEKUTIMIT,
KONTROLLIT DHE RIMBURSIMIT TË RECETËS ELEKTRONIKE e-Rx”**

I. TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i procedurave, detyrave dhe funksionit të sistemit të recetës elektronike.
2. Kjo rregullore është e detyrueshme të zbatohet nga të gjithë dhënësit e shërbimit shëndetësor që në zbatim të kontratës me Fondin, kanë detyrimin të gjenerojnë, përdorin recetën elektronike si dhe nga Drejtoritë Rajonale, Degët dhe Agjensitë e Fondit që pranojnë, kontrollojnë dhe rimbursojnë recetën elektronike sipas akteve të dala nga Drejtoria e Përgjithshme e Fondit.
3. Përdoruesit e sistemit, siç janë të përcaktuar në Rregulloren e recetës elektronike janë:
 - a) Mjekët, që pjesë të kontratës së tyre kanë përshkrimin e recetës me rimbursim:
 - i. Mjeku i përgjithshëm i familjes,
 - ii. Mjeku i kontraktuar nga Fondi për Shërbim Paliativ, të cilët lëshojnë recetë të rimbursueshme,
 - iii. Mjeku specialist në Spital,
 - iv. Mjeku në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP).
 - b) Farmacitë me kontratë me Fondin për rimbursimin e barnave:
 - i. Farmacitë e rrjetit të hapur,
 - ii. Agjensitë Farmaceutike të rrjetit të hapur,
 - iii. Farmaci në Spitale,
 - iv. Farmaci në IEVP.
 - c) Drejtoria e Përgjithshme, Drejtoritë Rajonale, Degët dhe Agjencitë nëpërmjet punonjësve që janë përgjegjës për:

- i. Pranimin e dosjes për rimbursimin e recetave elektronike nga subjektet farmaceutike,
- ii. Kontrollin e procesit të rimbursimit,
- iii. Administrimin dhe kontrollin e kujdesit shëndetësor parësor dhe spitalor,
- iv. Mbështetjen teknike për administrimin dhe kontrollin e procesit të Workflow të recetës elektronike/dosjes elektronike (Sektori i Informatikës dhe Statistikës),
- v. Likuidimin financiar të subjekteve (Sektori i Financës),
- vi. Administrimin dhe monitorimin në Drejtorinë e Përgjithshme.

4. Mjekët dhe farmacistët e kontraktuar me Fondin duhet:

- i. Të disponojnë dhe të kenë akses në programin e Recetës Elektronike (e-Rx),
 - ii. Të pajisen me përdorues dhe fjalëkalim,
 - iii. Të pajisen me nënshkrimin elektronik dhe PIN përkatës (Personal Identification Numer) sipas marrëveshjes që Fondi ka nënshkruar me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.
5. Të gjithë punonjësit e strukturave të Fondit të cilët kanë të drejtën e aksesit dhe të përdorimit të sistemit të recetës elektronike e-Rx, pas përcaktimeve të drejtorëve përkatës, janë të pajisur me përdorues dhe fjalëkalim.
6. Pranimi i dosjes së subjektit farmaceutik dhe kalimi i dosjes nga një sektor në tjetrin bëhet kundrejt shënimave në një kartelë shoqëruese, ku firmosin personat që marrin në dorëzim dhe veprojnë për kontrollin e dosjes për rimbursimin e recetave elektronike të subjektit farmaceutik, sipas dokumentit të unifikuar bashkëngjitur kësaj rregullore. Procesi i pranimit, verifikimit dhe kontrollit të dosjes përkatëse të subjektit farmaceutik është i gjurmueshëm nga sistemi i recetës elektronike e-Rx.

II. RREGULLAT BAZË TË REÇETËS ELEKTRONIKE E-RX

Në përshkrimin e barnave në recetën elektronike me rimbursim do të zbatohen të gjitha rregullat në fuqi për përshkrimin e barnave të rimbursuara dhe recetës me rimbursim të plotë dhe të pjesshëm. Në mënyrë specifike për përshkrimin, gjenerimin dhe ekzekutimin e Recetës Elektronike e-Rx, do të zbatohen kriteret si më poshtë:

1. Receta Elektronike me rimbursim do të gjenerohet për pacientët të cilët janë në regjistrin e të siguruarve që Fondi disponon, si dhe të ketë jo më pak se një kategori përfitimi të vlefshme në momentin e gjenerimit të recetës elektronike.
2. Çdo Recetë elektronike që do të gjenerohet nga mjeku do të ketë vlefshmëri vetëm për:
 - i. Një kategori,
 - ii. Një diagnozë,
3. Receta elektronike me rimbursim do të gjenerohet nga mjeku përkatës i familjes i cili mbulon me shërbim shëndetësor si dhe ka të rregjistruar në rregjistrin e tij elektronik të të siguruarve këtë pacient. Në rastet e mungesave të mjekut, do të zbatohen udhëzimet specifike të Fondit.
4. Mjekët e IEVP-së do të gjenerojnë recetë elektronike për pacientët të cilët janë në regjistrin e të siguruarve që Fondi disponon si dhe kanë kategori përfitimi IEVP aktive në momentin e gjenerimit.

5. Mjekët Specialist në Spitäle Rajonale do të gjenerojnë recetë elektronike për pacientët e këtij rajoni, të cilët janë në regjistrin e të siguruarve që Fondi disponon, si dhe të ketë jo më pak se një kategori përfitimi të vlefshme në momentin e gjenerimit të recetës elektronike.
6. Mjekët Specialist në Spitälet Univeristare do të gjenerojnë recetë elektronike për pacientët e të gjithë vendit, të cilët janë në regjistrin e të siguruarve që Fondi disponon, si dhe të ketë jo më pak se një kategori përfitimi të vlefshme në momentin e gjenerimit të recetës elektronike.
7. Mjekët e kontraktuar nga Fondi për Kujdesin Paliativ, do të gjenerojnë recetë elektronike të rimbursoeshme për pacientët e rajonit përkatës, të cilët janë në regjistrin e të siguruarve që Fondi disponon si dhe kanë kategori përfitimi të vlefshme me rimbursim të plotë në momentin e gjenerimit të recetës elektronike.
8. Receta elektronike do të ketë afat për ekzekutim brenda 7 (shtatë) ditësh, sipas formatit të llogaritur nga sistemi Ditë/ Muaj/Vit dhe Orë/ Minutë, Sekondë (këtu e në vijim dd/mm/vvvv dhe oo/mm/ss) nga momenti i gjenerimit të saj nga mjeku. Përjashtim nga rregull do te bëjnë rastet kur në recetë përshkuhen antibiotikë, dhe afati i ekzekutimi do të jetë brenda 3 (tre) ditësh nga momenti i gjenerimit.
9. Në recetat me rimbursim të pjesshëm dhe ato të kategorisë “Pensionist” do të lejohen deri në 3 (tre) barna për recetë.
10. Mjeku mund të lëshojë recetë me rimbursim me kohëzgjatje më të madhe se 2 muaj, vetëm pas miratimit të DRF/DAPSHEΤ sipas udhëzimeve të Fondit.
11. Mjeku mund të lëshojë në mënyrë automatike 3 receta me rimbursim, me vlefshmëri 2 mujore, pa mbivendosje vlefshmërie dhe skemë trajtimi të njëjtë, në një vizitë mjekësore, në rastet kur të sëmurët kronikë kanë një gjendje shëndetësore të stabilizuar.
12. Mjeku nuk duhet të lëshojë recetë me rimbursim për të njëjtën diagnozë pa mbaruar periudha e trajtimit të recetës së mëparshme për këtë diagnozë. Përjashtim nga sa më sipër do të jenë rastet si vijojnë:
 - a. Rastet kur recetës elektronike i ka kaluar afati i ekzekutimit sipas pikës 8 dhe nuk është ekzekutuar, atëherë mjekut i jepet e drejta të lëshojë për të njëtin pacient për të njëjtën diagnozë, recetë për të dytën herë.
 - b. Rastet e trajtimit me barna spitalor të pacientit për diagnozë e cila trajtohet me më shumë se dy barna me kohëzgjatje të ndryshme sipas skemave të mjekimit branda të njëjtës periudhë. Në këtë rast kalohet në nivelin e alertimit të kësaj situate, pranë mjekut të DAPSHEΤ/DRF, i cili konfirmon procedimin e kësaj recete.
13. Receta elektronike e gjeneruar nga mjeku i familjes do të ekzekutohet vetëm nga farmacitë e kontraktuara brenda të njëjtës ndarje teritoriale që mbulon Drejtoria Rajonale përkatëse. Ekzekutimi i recetës elektronike në farmaci të tjera jashtë këtij territori bëhet vetëm me miratim nga Drejtoria Rajonale që mbulon atë territor.

14. Asnjë recetë nuk do të rimbursohet nga DRF, në qoftë se receta elektronike nuk përmban nënshkrimin elektronik të Farmacistit të farmacise së rrjetit te hapur, me kontratë me Fondin.. Përjashtim nga sa më sipër do të jetë një periudhë tranzitore, deri në momentin që të gjithë Farmacistët do të pajisen me Nënshkrimin Elektronik, si dhe me urdhër/udhëzimin përkatës për përdorimin e Nënshkrimit Elektronik nga ana e farmacistit të farmacisë së rrjetit të hapur. Gjatë kësaj periudhe farmacia do të printoje recetat , do ti nënshkrujë dhe vulosë me vulë të njomë.
15. Farmacia nuk mund të ekzekutojë recetën, nëse sasia e barnave të përshkruara në recetë është më e madhe se sasia e barnave në gjëndjen kontabël dhe fizike.
16. Në çdo rast ekzekutimi i recetës do të bëhet i plotë për të gjitha barnat që përmban dhe jo vetëm për barna të veçantë.
17. Farmacia me përfundimin e muajit kalendarik, procedon në sistem kërkesën e re përimbursim, plotëson dosjen dhe e dorëzon pranë Drejtorisë Rajonale përkatëse. Dorëzimi / pranimi i dosjes do të kryhet një herë në muaj.

Përjashtim nga sa më sipër do të jetë një periudhë tranzitore, deri në momentin që të gjithë Farmacistët do të pajisen me Nënshkrimin Elektronik, si dhe me urdhër/udhëzimin përkatës për përdorimin e Nënshkrimit Elektronik nga ana e farmacistit të farmacisë së rrjetit të hapur. Gjatë kësaj periudhe farmacia do të printoje recetat , do ti nënshkrujë dhe vulosë me vulë të njomë dhe dorezimi/pranimi i dosjes do të kryhet sipas detyrimeve kontraktuale në fuqi.

III. PËRSHKRIMI DHE GJENERIMI I RECETËS ELEKTRONIKE NGA MJEKU

1. A) Mjeku i përgjithshëm i familjes mbasi kryen vizitën e pacientit dhe përcakton diagnozën, do të fillojë procesin e regjistrimit të Recetës Elektronike në sistem.
B) Sipas sistemit të referimit dhe udhëzimit të Fondit, për përshkrimin e barnave që tregëtohen në farmacitë e spitaleve, mjeku specialist i spitalit i kontraktuar me Fondin përlëshimin e recetës me rimbursim, pasi dokumenton Konsultën e Shërbimit përkatës në kartelën e pacientit, do të fillojë procesin e regjistrimit të Recetës Elektronike në sistem.
2. Hapi i parë për regjistrimin e saj është hyrja në sistemin online të e-Rx, i cila konsiston në vendosjen e kodit të përdoruesit (NID) dhe fjalëkalimit respektiv / PKI. Pas hyrjes në sistem, mjeku evidenton pacientin në Registrin online të Recetës Elektronike.
3. Evidencimi i pacientëve nis nëpërmjet vendosjes së Numrit Personal të Identifikimit (NID). Kryhet marrja e të dhënave nëpërmjet ndërveprimit me sistemin e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, në këtë mënyrë do të ngarkohen automatikisht nga regjistri i gjëndjes civile të dhënat e fushave si:
 - a. NID
 - b. Emri,
 - c. Mbiemri,
 - d. Data e lindjes,
 - e. Gjinia
 - f. Vendlindja
 - g. Qyteti
 - h. Adresa

4. Sistemi ndërvepron me Regjistrin Elektronik të të Siguruarve që disponon Fondi, nga ku ngarkohen të dhënat si:
- a. kodi i pacientit
 - b. kategoritë e pacientit (të paktën një kategori e vlefshme për përfitim)
5. Në sistem paraqitet fusha <<Shënime>> (opcionale), ku nga ana e mjekut mund të plotësohen të dhëna mbi numrin e kartelës fizike të pacientit apo informacione të tjera që i vijnë në ndihmë mjekut.
6. Pas identifikimit të pacientit në Regjistrin online të sistemit të Recetave Elektronike, mjeku mund të shohë historikun e mjekimeve të pacientit, nëse pacienti ka një historik në sistem, në mënyrë që të konsultohen të gjitha trajtimet mjekësore dhe barnat që mund t'i jenë lëshuar më parë pacientit, dhe konsultat e referuara.
7. Mjeku bën regjistrimin e një recete të re, ku plotëson të dhënat në fushat e mëposhtme të cilat përbëjnë informacionin kryesor të recetës:
- a. *Tipi i recetës*, një mjek nuk mund të vijojë më tej nëse fillimi nuk ka përzgjedhur një nga alternativat e mëposhtme:
 - i. Kronike përsëritëse
 - ii. Kronike e re
 - iii. Akute
 - b. *Ndryshim terapie*, një mjek nuk mund të vijojë me tej nëse fillimi nuk ka përzgjedhur një nga alternativat e mëposhtme:
 - i. Po
 - ii. Jo
 - c. *Diagnoza* (kërkimi bëhet nëpërmjet kodit ose emërtimit të saj)
 - d. *Kohëzgjatja e mjekimit*
 - e. *Përshkrime* (Opsionale), e cila i jep mundësi mjekut të vendos informacion shtesë rreth recetës nëse ka.
 - f. *Ditë*: *Mjeku duhet të ketë kujdes, që numri i ditëve të vendosura në këtë qelizë, të jetë në përputhje me kohëzgjatjen e mjekimit dhe sasinë që do rekomandohet.
 - g. *Numri dhe Data e registrat*
 - h. *Numri dhe Data e konsultës*, duhet të plotësohet nga mjeku për barna të cilat e kanë detyrim
8. Në sistem e recetës elektronike ka fusha për të cilat shfaqen tabela paralajmëruese dhe udhëzuese si fusha të detyrueshme me (*). Mosplotësimi i fushave të detyrueshme nuk lejon përshkrimin dhe gjenerimin e recetës, si:
- a. *Vendosja e NID*- shërben sipas përcaktimit në pikat 3 dhe 4.
 - b. Një mjek nuk mund të shtojë një bar nëse fillimi nuk ka plotësuar fushat e mëposhtme:
 - i. *Tipi i recetës*, një mjek nuk mund të vijojë me tej nëse fillimi nuk ka përzgjedhur një nga alternativat si cilësuar në pikën 7/a të këtij kreu.
 - ii. *Ndryshim terapie*, një mjek nuk mund të vijojë me tej nëse fillimi nuk ka përzgjedhur një nga alternativat si cilësuar në pikën 7/b të këtij kreu
 - iii. *Kohëzgjatja e recetës*,

- iv. *Diagnoza*, duhet të zgjidhet diagnoza nëpërmjet emërtimit apo kodit të saj,
 - v. *Numri dhe data e regjistrat*,
 - vi. *Numri dhe data e konsulës*, për barnat të cilat e kanë të detyruar konsultën e specialitetave.
- c. Në mënyrë që mjeku të procedojë me konfirmimin e recetës, në rubrikën "përshkrimi i barnave" është i detyrueshëm plotësimi i fushave të mëposhtme:
 - i. *Terapia e rekomanduar*, duhet të plotësohet terapia nga mjeku për çdo bar (psh, 2*1, 3*1/2, etj.)
 - ii. *Sasia e rekomanduar*, duhet të plotësohet sasia (sasia për njësi bazë), në përputhje me terapinë e rekomanduar dhe kohëzgjatjen e mjekimit
- 9. Pas plotësimit të këtyre fushave shtohen barna ku kërkimi për një bar bëhet nëpërmjet principit aktiv.
- 10. Përjashtim bëjnë barnat e përshkruara për pacientët me kategori të vlefshme "Veteran" ose "Invalid Lufte", për të cilat mjeku mund të përshkruajë barnat sipas emërtimit tregtar, pas konsultës së mjekut specialist.
- 11. Mjeku kryen : ruajtjen e recetës, konfirmimin e saj dhe më pas proçedon me nënshkrimin elektronik të saj. Pas nënshkrimit elektronik të recetës nga mjeku, në sistem shfaqet kodi identifikues i recetës, i gjeneruar nga sistemi, me të cilin duhet të pajiset pacienti.
- 12. Rregullat e hollësishme të ndërveprimit të mjekut me programin jepen me manualin e përdorimit të mjekut, i cili është i publikuar në faqen Web të aksesimit të sistemit të recetës elektronike.
- 13. Për konfirmimin e recetës elektronike nga DAPSHET/DRF, për barnat që tregëtohen nga Farmacite e Spitaleve
 - a. Pacienti (familjar i tij ose çdo person tjeter i autorizuar nga ai) me numrin identifikues të recetës nga sistemi, paraqitet brenda afatit të vlefshmërisë së recetës pranë DAPSHET/DRF.
 - b. Hapi i parë për aksesimin e sistemit të Recetës Elektronike për specialistin e DAPSHET/DRF është ai i hyrjes në sistem. Pas hyrjes në sistem, specialisti plotëson kodin identifikues të e-Recetës dhe në programin e tij software shfaqet receta elektronike sipas përshkrimit të mjekut. Specialisti i DAPSHET/DRF verifikon recetën e gjeneruar nga mjeku specialist i spitalit.
 - c. Në këtë proces kryhet kontrolli i përgjithshëm i elementëve të recetës elektronike të gjeneruar për:
 - i. Dhënien e barit dhe terapinë, në përputhje me kufizimet e listës dhe protokollin e përdorimit të barit.
 - ii. Kohëzgjatjen e recetës në përputhje me udhëzimet e Fondit dhe sasinë e barnave të përshkruar.
 - iii. Kontrollon recetën për konsultën e bërë nga shërbimi përkatës i QSUT-së.

- d. Në rastet kur vërehen shkelje të cilësuara më lart, si dhe në çdo rast tjeter, specialistit të DAPSHE/T/DRF i lind e drejta të mos konfirmojë recetën elektronke dhe të kthejë të sëmurin tek mjeku për ripërkrim të recetës ose anullim të saj.
 - e. Specialisti DAPSHE/T/DRF konfirmon alternativën e barit të zgjedhur nga pacienti, për barnat nga regjistri i barnave të AKBPM-së (ku janë të evidentuara vetëm barnat e LBR-së që tregtohen në farmacitë e spitaleve), ku për çdo bar shfaqet çmimi referencë, çmimi i rimbursimit, çmimi i pacientit dhe sasia që ka përkruar mjeku për këtë bar.
 - f. Pas konfirmimit të recetës, firmoset dhe vuloset nga specialisti i DAPSHE/T/DRF si dhe n
 - g. Në rastet kur bari është me bashkëpagesë, diferenca e pagesës kryhet në arkën pranë DAPSHE/T/DRF. Në përfundim receta i dorëzohet pacientit, i cili drejtohet në farmacinë e spitalit për tërheqjen e barnave.
 - h. Afati për konfirmim/refuzim të recetës nga DAPSHE/T/DRF duhet të jetë brenda afatit 7 (shtatë) ditor të ekzekutimit të recetës.
14. Mjeku mund të lëshojë recetë me rimbursim për rastet e personave që largohen jashtë shtetit, me kohëzgjatje më shumë se dy muaj, për një periudhë deri 6 (gjashtë) mujore. Pas përzgjedhjes së kohëzgjatjes mjekut duhet ti shfaqet fusha e detyrueshme për plotësim e miratimit nga DRF/DAPSHE(numër, datë).
15. Në rastet kur të sëmurët kronikë kanë një gjendje shëndetësore të stabilizuar, mjeku mund të lëshojë në mënyrë automatike 3 receta me rimbursim, me vlefshmëri 2 mujore. Mjekët do të plotësojnë recetën me rimbursim me vlefshmëri 2-mujore (dhe automatikisht sistemi plotëson 2 receta përsëritëse me vlefshmëri 2-mujore për muajt vijues pa mbivendosje vlefshmërie).

IV. PËRDORIMI I SISTEMIT TË RECETËS ELEKTRONIKE NGA FARMACIA

Aktiviteti i farmacisë në sistemin e recetës elektronike zhvillohet në dy drejtime:

- A. Regjistrimi i faturave hyrje-dalje të barnave të rimbursueshme dhe inventarin e gjendjes fizike të barnave.
 - B. Identifikimi, ekzekutimi, konfirmimin dhe nënshkrimi i recetës.
- A. **Regjistrimi i faturave hyrje-daljeve të barnave të rimbursuara dhe inventarin e gjendjes fizike të barnave**
1. Në zbatim të akteve ligjore në fuqi, të Fondit, farmacia regjistron inventarin e gjendjes fizike të barnave të rimbursueshme brenda afatit të përcaktuar.
 2. Farmacia regjistron të dhënat e Faturave hyrje-daljeve të barnave të rimbursuara, brenda afatit të përcaktuar në kontratën e subjekteve me Fondin. Mënyra e hedhjes së dokumentacionit bëhet sipas manualit për Farmacinë, i cili është publikuar në faqen Web të aksesimit të sistemit të recetës elektronike.

3. Sistemi lehtëson përbushjen e detyrimeve të farmacisë duke gjeneruar automatikisht dokumentat e nevojshme për reimbursim si:
 - a. Listëtreguesin sipas kategorive
 - b. Listëtreguesi i recetave me reimbursim për periudhën dd/mm/vvvv dhe oo/mm/ss - dd/mm/vvvv dhe oo/mm/ss (listëtreguesi analistik);
 - c. Lista e hyrjeve - daljeve për periudhën: dd/mm/vvvv - dd/mm/vvvv, (pasqyra përbledhëse e fletëdaljeve - fletëhyrjeve);
 - d. Inventari i gjendjes fizike të barnave në momentin e printimit sipas formatit dd/mm/vvvv dhe oo/mm/ss.

B. Identifikimi, ekzekutimi, konfirmimi dhe nënshkrimi i recetës

1. Pacienti me dokumentin e identifikimit dhe kodin identifikues të recetës i drejtohet farmacisë.
2. Pas hyrjes me sukses në sistem, farmacisti identifikon ne sistem pacientin duhe vendosur NID e patientit dhe më pas plotëson kodin identifikues të recetës dhe në sistem i shfaqet receta elektronike sipas përshkrimit të mjekut.
3. Farmacia duhet të dakortësojë me pacientin mbi elementët e recetës elektronike, përpara se të kryejë ekzekutimin, si dhe në varësi të principit aktiv që ka përshkruar mjeku, farmacia bën përzgjedhjen e alternativave përkatëse të listës së barnave. Farmacisti pasi përzgjedh alternativën e barit nga regjistri i barnave të AKBPM-së (ku janë të evidentuara me po ose jo barnat e LBR-së), ku për çdo bar shfaqet çmimi dhe sasia që ka përshkruar mjeku për këtë bar.
4. Farmacia të ekzekutojë recetën në përputhshmëri me tipin e recetës, kohëzgjatjen e mjekimit dhe me terapinë e rekomanduar. Në përfundim të përzgjedhjes së alternativave për çdo bar në recetë, farmacisti vazhdon procedurën e konfirmimit të recetës dhe nënshkrimit të saj.
5. Receta duhet të përbajë nënshkrimin elektronik të farmacistit që egzekuton recetën në farmacinë e rrjetit të hapur me kontrate me Fondin. Përashtim nga sa më sipër do të jetë një periudhë tranzitore, periudhë gjatë së cilës, Farmacisti do të pajiset me Nënshkrim Elektronik, deri në momentin e pajisjes të të gjithë Farmacistëve me Nënshkrim Elektronik si dhe urdhërit/udhëzimit përkatës përdorimin e Nënshkrimit Elektronik nga ana e farmacisteve. Farmacia do të shtypë/printojë recetat do t'i nënshkruaj dhe vulos me vulë të njomë.

V. PËRDORIMI I SISTEMIT TË RECETËS ELEKTRONIKE NGA FARMACIA E SPITALIT

Aktiviteti i farmacisë në sistemin e recetës elektronike zhvillohet në dy drejtime:

- A. Regjistrimi i faturave hyrje-dalje të barnave të reimbursuara dhe inventarin e gjendjes fizike të barnave.
 - B. Identifikim, ekzekutim, konfirmim dhe nënshkrimi i recetës.
- A. Regjistrimi i faturave hyrje-daljeve të barnave të reimbursuara dhe inventarin e gjendjes fizike të barnave.**
1. Në zbatim të akteve ligjore në fuqi, të Fondit, farmacia regjistron inventarin e gjendjes fizike të barnave të reimbursuara brenda afatit të përcaktuar.

2. Farmacia regjiströn të dhënat e faturave hyrje-daljeve të barnave të rimburzuara, brenda afatit të përcaktuar. Mënyra e hedhjes së dokumentacionit bëhet sipas manualit të përdorimit për Farmacinë.
3. Sistemi lehtëson përrnbushjen e detyimeve të farmacisë duke gjeneruar automatikisht dokumentat e nevojshme për rimbursim si:
 - a. Listëtregues sipas kategorive.
 - b. Listëtregues i recetave me rimbursim për periudhën dd/mm/vvvv dhe oo/mm/ss - dd/mm/vvvv dhe oo/mm/ss (listëtreguesi analistik);
 - c. Lista e hyrjeve- daljeve për periudhën: dd/mm/vvvv - dd/mm/vvvv, (pasqyra përbledhëse e fletëdaljeve - fletëhyrjeve).
 - d. Inventari i gjëndjes fizike të barnave në momentin e printimit sipas formatit dd/mm/vvvv dhe oo/mm/ss.

B. Identifikim, ekzekutim, konfirmim dhe nënshkrimi i recetës

1. Pacienti me dokumentin e identifikimit, kodin identifikues të recetës dhe mandat arkëtimin e vlerës së bashkëpagesës, i drejtohet farmacisë të spitalit.
2. Pas hyrjes me sukses në sistem, farmacisti identifikon pacientin duke vendosur NID e pacientit dhe më pas plotëson kodin identifikues të recetës dhe në sistem i shfaqet receta elektronike sipas përshkrimit të mjekut specialist dhe konfirmimit nga DAPSHET/DRF/DF.
3. Farmacia të ekzekutojë recetën në përputhshmëri me tipin e recetës, kohëzgjatjen e mjekimit dhe me terapinë e rekomanduar. Farmacia e spitalit nuk ka të drejtë të ndryshojë sasinë e përshkruar nga ana e mjekut. Farmacia e spitalit nuk ka të drejtë të ndryshojë barin e përshkruar nga specialisti DAPSHET/DRF/DF
4. Farmacisti i Spitalit vazhdon procedurën e konfirmimit të recetës dhe nënshkrimin elektronik të saj nga ana e farmacistit që bën egzekutimin e recetës.
5. Farmacia e spitalit dorëzon dosjen në DAPSHET/DRF sipas kontratës në fuqi. Pas pranimit të dosjes nga DAPSHET/DRF, farmacia nuk mund të ndryshojë më vlerat e hedhura.

VI. PRANIMI I DOSJES SË SUBJEKTIT FARMACEUTIK NGA DREJTORIA RAJONALE / DEGA RAJONALE E FONDIT

A. Për farmacitë e rrjetit të hapur

Procesi i pranimit të dosjes për rimbursimin e recetave elektronike të një subjekti farmaceutik (farmaci, Agjenci farmaceutike) do të kryhet sipas një grafiku të miratuar nga Drejtori i Drejtorisë/Degës Rajonale të Fondit, i cili do të publikohet pranë sportelit ku do të bëhet pranimi i dosjes. Specialisti/et i/e caktuar për procesin e pranimit, pranë sektorit të pranim-imbursimit, merr në dorëzim dosjen e paraqitur nga përfaqesuesi i autorizuar i farmacisë (autorizim i vlefshëm, i lëshuar nga drejtuesi teknik).

1. Dosja e paraqitur nga subjekti farmaceutik duhet të përbajë:

- a. Listëtregues sipas kategorive, (përbledhëse nga Sistemi i Recetës Elektronike e-Rx).
- b. Listë treguesi i recetave me rimbursim për periudhën dd/mm/vvvv dhe oo/mm/ss - dd/mm/vvvv dhe oo/mm/ss (listëtreguesi analistik) nga Sistemi i Recetës Elektronike e-Rx.
- c. Lista e hyrjeve - daljeve dhe daljeve për periudhën: dd/mm/vvvv - dd/mm/vvvv, (pasqyra përbledhëse e fletëdaljeve-fletëhyrjeve).
- d. Në rastet e recetave të kategorisë veteran lufte dhe invalid lufte, farmacia duhet të dorëzojë kopjet e faturave origjinale nga depot të vulosura nga farmacia, (ku bari i dhënë në faturë të shënohet me shenjën (x), si dhe të shënohet numri i recetës elektronike).

Përjashtim nga sa më sipër do të jetë një periudhë tranzitore, periudhë gjatë së cilës, Farmacisti do të pajiset me Nënshkrim Elektronik, deri në momentin e pajisjes të të gjithë Farmacistëve me Nënshkrim Elektronik si dhe urdhërit/udhëzimit përkatës për përdorimin e Nënshkrimit Elektronik nga ana e farmacisteve. Farmacia do të shtypë/printojë recetat do t'i nënshkruaj dhe vulos me vulë të njomë.

2. Dokumentat e mësipërme pika a, b dhe c duhet të janë të printuara të firmosura dhe të vulosura me vulë të njomë. Specialisti i sektorit të pranim-imbursimit, në prani të përfaqësuesit të autorizuar të subjektit farmaceutik kryen këto veprime:
 - a. Evidenton subjektin farmaceutik në sistem.
 - b. Kontrollon rregullsinë formale të listëtreguesve të dosjes, numrin e recetave në dosje, regjistrat të fletëhyrjeve, procesverbalit përbledhës, firmën dhe vulën.
 - c. Firmos procesverbalin e pranimit, hap kartelën shoqëruese të dosjes si dhe konfirmon pranimin e dosjes në programin e-Rx.
3. Specialisti i sektorit të pranim-imbursimit vendos numrin e personalizuar të dosjes në kartelën shoqëruese i cili përbëhet nga numri rendor i subjekteve të paraqitura atë ditë/data/orë e paraqitjes.

B. Për farmacinë e spitalit

1. Procesi i pranimit të dosjes për rimbursimin e recetave elektronike të Farmacisë së spitalit bëhet sipas kontratës në fuqi. Specialisti i caktuar për procesin e pranimit (Specialist i Sektorit të Rimburimit të Barnave) merr në dorëzim dosjen e paraqitur nga përfaqësuesi i farmacisë së spitalit.
2. Dosja e paraqitur nga farmacia e spitalit duhet të përbajë:
 - a. Proses verbal dhe listëtreguesin sipas kategorive, përbledhës nga sistemi e-Rx
 - b. Listëtreguesin e recetave me rimbursim (nga Sistemi e-Rx) për periudhën dd/mm/vvvv dhe oo/mm/ss - dd/mm/vvvv dhe oo/mm/ss
 - c. Lista e hyrjeve dhe daljeve për periudhën dd/mm/vvvv - dd/mm/vvvv.
 - d. Recetat elektronike për periudhën dd/mm/vvvv dhe oo/mm/ss - dd/mm/vvvv dhe oo/mm/ss (receta të konfirmuara nga specialistët e kontrollit të DAPSHET/DRF dhe të nënshkruara nga Farmacia e Spitalit)
 - e. Faturat origjinale të daljeve të depove importuese të kontraktuara nga Fondi.

3. Dokumentat e mësipërme, pika a, b dhe c duhet të jenë të printura nga sistemi e-Rx (të firmosura dhe të vulosura me vulë të njomë). Specialisti i pranimit, në prani të përfaqësuesit të autorizuar të farmacisë së spitalit kryen këto veprime:
 - a. Kontrollon rregullsinë formale të listëtreguesve, numrin e recetave, regjistrin e fletëhyrjeve, procesverbalin përbledhës, firmën dhe vulën.
 - b. Firmos procesverbalin e pranimit, kartelën shoqëruese të dosjes si dhe konfirmon pranimin e dosjes në programin e-Rx.

VII. KONTROLLI I RECETAVE NGA SEKTORI I RIMBURSIMIT

A. Për farmacitë e rrjetit të hapur

1. Dosjet e pranuara on-line nga specialisti i sektorit të pranim-imbursimit, si dhe dosjet fizike depozithen pranë përgjegjësit të sektorit të pranim-imbursimit i cili delegon edhe on-line për kontroll të mëtejshëm te specialistët e këtij sektori, duke bërë shënimet përkatëse edhe në kartelën shoqëruese të dosjes fizike. Specialisti i imbursimit bën praninim dhe vlerësimin e dosjes.
2. Në këtë proces do të kryhet kontrolli i përgjithshëm i elementeve të recetës elektronike të gjeneruar dhe ekzekutuar nga farmacia nëse këto element janë në përputhje me recetën e gjeneruar nga mjeku. Më konkretisht si më poshtë:
 - a. Kontrollon recetën për kategorinë veteran lufte dhe invalid lufte (alternativën tregtare në përputhje me alternativën e përshkruar nga mjeku si dhe saktësin e vlerës shtesë nëpërmjet kopjes së fletëhyrjes).
 - b. Kontrollon kohëzgjatjen dhe terapinë e mjekimit.
 - c. Kodi i Qendrës Shëndetësore.
 - d. Respektimi i numrit të barnave në recetën me imbursim të pjesshëm.
3. Për recetat që evidentohen si të parregulla, do të bëhet printimi i tyre si dhe do të hartohet një proces-verbal nga ana e specialistit të kontrollit të recetave si dhe do të bëhet mospranimi (un-check) i plotë ose i pjesshëm (i një ose më shumë rreshtave) të recetave në sistem duke shtruar arsyet përkatëse. Në proces-verbal do të shënohen në bazë të numrit të recetës, të gjitha parregullsitë, të cilat nuk do të kalojnë në procesin e imbursimit. Edhe kjo kategori recetash do të vazhdojë të jetë pjesë e dosjes së farmacisë së bashku me proces-verbalin përkatës.
4. Specialisti mbas kontrollit të secilës nga pikat e sipërmendura bën Check dhe konfirmon në raste rregullsie, në të kundërt vendos shenjën përkatëse për tu identifikuar si jo e rregullt, duke vendosur arsyet e mos pranimit për imbursim nga ky specialist. Në përfundim të këtij procesi konfirmohet mbyllja e kontrollit të kësaj dosje, duke printuar procesverbalin përkatës për këtë subjekt e cila bëhet pjesë e dosjes fizike (e firmosur nga specialisti). Kontrolli i recetave nga ky sektor duhet të realizohet brenda 3 (tre) ditëve punë nga dita e marrjes së dosjes nga specialisti i pranimit.
5. Përgjegjësi i sektorit të pranim-imbursimit monitoron respektimin e afatit të kontrollit të recetave. Specialisti i sektorit të imbursimit e përcjell dosjen drejt sekorit të Kontrollit Shëndetësor Parësor.

B. Për farmacinë e spitalit

Pas pranimit të dosjes fizike nga specialisti i pranimit (në Sektorin e Rimbursimit të Barnave), përgjegjësi i sektorit bën check dhe konfirmon në sistemin e-Rx kontrollin e dosjes së farmacisë (pasi recetat janë kontrolluar nga specialistët e sektorit para ekzekutimit në farmaci, referuar pikës 12 ,Kreu III i kësaj rregullore) dhe e përcjell dosjen në sektorin e financës.

VIII. KONTROLLI I RECETAVE NGA SEKTORI I KONTROLLIT SHËNDETËSOR PARËSOR

1. Pasi mbaron kontrollin nga sektori i pranim-imbursimit, dosja e subjektit farmaceutik kalon tek Sektori i Kujdesit Shëndetësor Parësor e Spitalor duke firmosur kartelën shoqëruese. Përgjegjësi i sektorit bën praninim e dosjes në sistem, shënimet përkatëse në kartelën shoqëruese të dosjes dhe shpërndarjen e tyre te specialisti i kontrollit të recetave, ku kontrollohen nga mjekët e sektorit për elementët e mëposhtëm:
 - a. Për dhënien e barnave duke respektuar kufizimet dhe protokollet e listës së barnave të rimburzuara në fuqi.
 - b. Lëshimi i recetave të veçanta për barnat narkotikë dhe psikotrop.
 - c. Verifikimi i kohëzgjatjes së mjekimit me sasinë e barit.
 - d. Nëse është përcaktuar saktë rasti i ri ose ndryshimi i terapisë.
 - e. Përputhshmérinë e medikamentit me kategorinë e pacientit.
 - f. Përputhshmérinë e barnave me diagnozën e shënuar.
 - g. Verifikim i numrit dhe datës së konsultës për barnat që e kanë të detyrueshme sipas akteve në fuqi
2. Nga ana e specialistit mjek në momentin e verifikimit të recetave të bëhet mospranimi i plotë ose i pjeshëm (un-check i një ose më shumë rreshtave) të recetës, vetëm për recetat e parregullta. Specialisti i këtij sektori mban një akt-konstatim në dy kopje ku liston të gjitha recetat të cilat nuk janë lëshuar në përputhje me udhëzimet në fuqi të skemës së sigurimeve duke i ndarë sipas problematikave që paraqesin. Një kopje e verifikimit bëhet pjesë e dosjes.
3. Recetat me probleme do të kalojnë në procesin e rimburimit, por kopjet e këtyre recetave së bashku me kopjen e akt-verifikimit përkatës, do të paraqiten pranë përgjegjësit të Sektorit/Drejtoret të Drejtorisë dhe për verifikimin e tyre hartohet një program kontrolli sipas rastit, pranë mjekut/QSH/pacientit.
4. Specialisti i këtij sektori gjithashtu njihet edhe me akt-verifikimin e mbajtur nga sektori i rimburimit. Bazuar nga problematikat e paraqitura në të, specialisti i relaton përgjegjësit të sektorit të Kontrollit Shëndetësor Parësor dhe mban procesverbal për atë shkelje të mjekut për të cilën në bazë të kontratës në fuqi mes Fondit dhe QSH, janë parashikuar sanksione për mjekun. Përgjegjësi/Drejtori i Drejtorisë Rajonale, pasi i njeh mjekët me procesverbalet e shkeljeve të konstatuara, vendosin penalitetë sipas kontratës QSH/vitit përkatës.
5. Kontrolli i recetave nga ky sektor duhet të realizohet brenda tre ditëve pune nga dita e marrjes së dosjes nga sektori i rimbursimnit. Përgjegjësi i sektorit të KSHP-së monitoron

respektimin e afatit të kontrollit të recetave. Specialisti i kontrollit shëndetësor parësor bën shënimet në kartelën shoqëruese dhe ia kalon dosjen sektorit të statistikës.

IX. KONTROLI I DOSJES SË RECETAVE NGA SEKTORI I STATISTIKËS/INFORMATIKËS

1. Sektori i Statistikës/Informatikës merr në dorëzim dosjen e subjektit farmaceutik të kontrolluara nga sektori i Kontrollit Shëndetësor Parësor. Ky sektor pranon dhe konfirmon mbi rregullsinë e dosjes, gjithashtu check-on në sistem të gjitha pjesët përbërëse të dosjes në rast rregullsie dhe bën mbylljen e procesit të kontrollit përfundimtar.
2. Për recetat e papranuara gjenerohet konsum më vete, i cili është i dukshëm në sistem dhe njihet si konsum. Verifikon në sistem të gjithë dokumentacionin pjesë përbërëse të dosjes.
3. Kontrolli i dosjes nga ky sektor duhet të realizohet brenda një ditë pune nga dita e marrjes së dosjes nga sektori i përkatës. Përgjegjësi i sektorit të Statistikës/Informatikës monitoron respektimin e këtij afati. Sektori i Statistikës/Informatikës printon akt-rakordimet përfundimtare të subjektit farmaceutik.

X. PROCEDURA E PAGESAVE NGA SEKTORI I FINANCËS

A. Për farmacitë e rrjetit të hapur

1. Sektori i financës pasi merr në dorëzim dosjen e subjektit farmaceutik dhe akt-rakordinin të firmosur nga përgjegjësi i sektorit të Rimbursimit/KSHP/Statistikës/Informatikës dhe nga titullari i institucionit konfirmon në sistem vlerën e rimbursimit, proces-verbalet përkatës, listëtreguesin analistik të recetave nga Sistemi e-Rx, listëtreguesin përbledhës nga sistemi e-Rx, Pasqyën përbledhëse të faturave hyrje-dalje.
2. Subjektit i jepet një kopje e akt-rakordimit përfundimtar dhe lista e recetave të papranuara për rimbursim.
3. Sektori i financës nga vlera e njohur e rimbursimit (shuma e faturave) bën zbritjet e mëposhtme:
 - a. vlerën e penaliteteve nga sistemi e-Rx.
 - b. vlerën e dëmeve ekonomike nga kontolle të ndryshme që mund të jenë bërë (nëse ka).
 - c. dhe të tjera.
4. Vlera e mbetur pas zbritjeve, kalohet me urdhërëxhirim në llogarinë bankare të subjektit, siç përcaktohet në kontratë. Procesi i punës nga ky sektor duhet të realizohet brenda dy ditë pune nga dita e marrjes së dosjes nga sektori përkatës, Përgjegjësi i sektorit të Financës monitoron respektimin e këtij afati. Sektori i financës bën dhe mban kopje të dokumentacionit të nevojshëm që shoqërojnë urdhërëxhirimin.

B. Për farmacinë e spitalit


1. Sektori i Financës në DRF pasi merr në dorëzim dosjen e Farmacisë së Spitalit, dhe akt-rakordimin e firmosur nga përgjegjësi i sektorit të Rimbursimit/KSHP/Statistikës dhe nga titullari i institucionit, konfirmon vlerën e rimburimit, proces verbalet përkatës, listëtreguesin analistik të recetave nga sistemi e-Rx, listëtreguesin përbledhës nga sistemi e-Rx, pasqyrën përbledhëse të faturave hyrje-dalje dhe bën përpunimin e listëtreguesve sipas konsumit të importuesve farmaceutike, nga faturat e hyrje – daljeve të barnave të importuesve farmaceutike.
2. Sektori i Financës në DAPSHEΤ pasi merr në dorëzim dosjen e Farmacisë së Spitalit, konfirmon vlerën e rimburimit, proces verbalet përkatës, listëtreguesin analistik të recetave nga sistemi e-Rx, pasqyrën përbledhëse të faturave hyrje-dalje dhe bën përpunimin e listëtreguesve sipas konsumit të importuesve farmaceutikë, nga faturat e hyrje – daljeve të barnave të importuesve farmaceutike.
3. Printon akt-rakordimin sipas depove farmaceutike dhe bën gati dosjen për likudimin e faturave. Akt-Rakordimi nënshkruhet nga Përgjegjësi i Sektorit të Rimbursimit, specialisti i financës që përpunon dhe përgatit dosjen dhe nga titullari i Institucionit.
4. Procesi i punës nga ky sektor duhet të realizohet Brenda dy ditëve pune nga dita e marrjes nga sektori përkatës. Përgjegjësi i Sektorit të Financës monitoron këtë proces. Sektori i Financës mban kopje të dokumentacionit të nevojshëm që shoqërojnë urdhër xhirimin.

XI. ARKIVIMI DHE RUAJTJA E DOSJEVE TË SUBJEKTEVE FARMACEUTIKE

1. Dosja e subjektit farmaceutik pasi merret në dorëzim nga Sektori i financës, regjistrohet në regjistrin e arkivës duke u identifikuar me numrin e personalizuar të dosjes dhe me emrin e subjektit farnaceutik sipas kartelës shoqëruese të dosjes.
2. Dosja për arkivimin e subjekti farmaceutik, e cila përmban:
 - a. Kartela shoqëruese.
 - b. Listëtregues sipas kategorive, (përbledhës nga Sistemi e-Rx)
 - c. Listëtreguesi i recetave me rimbursim për përiudhen dd/mm/yyyy oo/mm/ss - dd/mm/yyyy oo/mm/ss (listë treguesi analistik) nga Sistemi e-Rx.
 - d. Lista e hyrjeve për përiudhën: dd/mm/yyyy oo/mm/ss - dd/mm/yyyy oo/mm/ss, (pasqyra përbledhëse e fletëdaljeve-fletëhyrjeve).
 - e. Kopjet e faturave origjinale të vulosura nga farmacia në rastet e recetave të kategorisë veteran lufte dhe invalid lufte.
 - f. Kopje të proces-verbaleve të hartuar nga sektorët përkatës.
 - g. Akt-rakordimi përfundimtar.
 - h. Kopje e urdhër xhirimit.

- i. Kopjet e faturave të daljeve të Importuesve, të muajit (vetëm për farmacitë e spitaleve).
 - j. Kopjet e kërkesave të bëra nga Drejtoria e Spitalit për çdo furnizim, (vetëm për farmacitë e spitaleve).
3. Dosja fizike arkivohet dhe ruhet sipas afateve ligjore për ruajtjen e recetave, të parashikuara në rregulloret e Fondit.

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.



DRF-

Kartelë Shqipëruese

Subjekti Farmaceutik:

Nipt:

Dreituesi Teknik:
(emërtimi i subjektit)

Nr. i dosjes së Subjektit:

Nipt:

Dreituesi Teknik:

(emërti mbiemër)

| Nr. | Specialisti i DRF (emërti mbiemër) | DRF | Pozicioni i punës | Sektori përkatës | Data e dorëzimit të dorëzim te Dosjes dosjes | Data e marries në Firma |
|-----|---------------------------------------|-----------|-------------------|------------------|--|----------------------------------|
| 1 | | Ekonomit | Pranimi | dd/mm/yyyy | dd/mm/yyyy | |
| 2 | | Farmacist | Pranimi | dd/mm/yyyy | dd/mm/yyyy | |
| 3 | | | Rimbursimi | dd/mm/yyyy | dd/mm/yyyy | |
| 4 | P/Zyres se Rimbursimit | | Rimbursimi | dd/mm/yyyy | dd/mm/yyyy | |
| 5 | | | | dd/mm/yyyy | dd/mm/yyyy | |
| 6 | P/Zyres se Mjekut | | Mjekut | dd/mm/yyyy | dd/mm/yyyy | |
| 7 | | | | dd/mm/yyyy | dd/mm/yyyy | |
| 8 | P/Sektorit te Statistikës | | Statistika | dd/mm/yyyy | dd/mm/yyyy | |
| 9 | | | | dd/mm/yyyy | dd/mm/yyyy | |
| 10 | Specialiste Statistike | | Informatika | dd/mm/yyyy | dd/mm/yyyy | |
| 11 | P/Finances | | Finance | dd/mm/yyyy | dd/mm/yyyy | |
| 12 | | | | dd/mm/yyyy | dd/mm/yyyy | |
| 13 | Arkiva | | Finance | dd/mm/yyyy | dd/mm/yyyy | |